



Република Северна Македонија

## Министерство за дигитална трансформација

### THIRRJE PUBLIKE

drejtuar njësisve të vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve të sektorit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut për krijimin e ueb faqeve zyrtare

#### Qëllimi i thirrjes

Në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës digjitale dhe rritjes së transparencës dhe qasjes së njësisve të vetëqeverisjes lokale, Ministria e Transformimit Digjital shpall Thirrje Publike drejtuar të gjitha komunave dhe institucioneve të sektorit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut për krijimin e një faqeje interneti moderne, funksionale dhe të qasshme.

Kjo thirrje është pjesë e iniciativës për digjitalizimin, kryesisht të vetëqeverisjes lokale, por gjithashtu edhe për përmirësimin e komunikimit të sektorit publik me qytetarët përmes zgjidhjeve moderne digjitale.

#### Çfarë do të përfitojnë komunat dhe institucionet e sektorit publik?

- Krijimin e një dizajni modern dhe funksional të faqes së internetit në një platformë të njohur
- Mbështetje për qasje dhe përmirësim të përvojës së përdoruesit
- Integrim me shërbimet dhe platformat digjitale që komuna tashmë i përdor
- Migrimin e të dhënave ekzistuese në faqen e re të internetit
- Trajnim për mirëmbajtjen dhe përditësimin e përmbajtjes nga shërbimet komunale
- Mirëmbajtje njëvjeçare e faqes së internetit

#### Të drejt aplikimi

Të drejtë aplikimi kanë të gjitha komunat dhe institucionet e sektorit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, pa marrë parasysh madhësinë e tyre, numrin e banorëve apo statusin aktual të faqes së tyre të internetit.

#### Mënyra e aplikimit

Komunat dhe institucionet e interesuara duhet të dorëzojnë një kërkesë me shkrim për pjesëmarrje në adresën elektronike:

Kërkesa duhet të përmbajë informacionet e mëposhtme:

1. Emri i komunës/institucionit
2. Person kontakti dhe të dhënat e kontaktit (telefon dhe email)
3. Përshkrim i shkurtër i faqes aktuale të internetit (nëse ekziston)

#### Afati për aplikim

Aplikimet mund të dorëzohen deri më 31.12.2025. Aplikimet do të përpunohen sipas parimit “i pari që vjen, i pari shërbehet” deri në mbushjen e numrit të disponueshëm të komunave dhe institucioneve



Република Северна Македонија

## Министерство за дигитална трансформација

që mund të përfshihen. Ministria do t'i njoftojë komunat dhe institucionet që kanë aplikuar për statusin e aplikacionit të tyre.

### **Nënshkrimi i kontratës**

Pas përfundimit të thirrjes publike, me çdo komunë dhe institucion që ka aplikuar do të nënshkruhet një kontratë për rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve midis Ministrisë së Transformimit Digjital dhe komunës/institucionit.

Me kontratën do të përcaktohen detajet për mënyrën e realizimit të aktiviteteve, detyrimet e të dyja palëve, koordinimi reciprok, afatet kohore dhe mënyra e mirëmbajtjes së ueb faqes.

### **Kontakt për informacione shtesë**

Interesi duhet të dorëzohet në email: [kristijan.kitevski@mdt.gov.mk](mailto:kristijan.kitevski@mdt.gov.mk) ose në adresën: Ministria e Transformimit Digjital, Bulevardi Filip II Maqedon, Nr. 11, 1000 Shkup. Për çdo pyetje dhe informacion shtesë, komunat mund të kontaktojnë në: telefon: 02/3200-915 dhe email: [kristijan.kitevski@mdt.gov.mk](mailto:kristijan.kitevski@mdt.gov.mk).

Ministria e Transformimit Digjital i inkurajon çdo komunë dhe institucion të sektorit publik të aplikojë dhe të shfrytëzojë mundësinë për një komunikim modern dhe interaktiv me qytetarët e tyre. Së bashku po ndërtojmë shoqërinë digjitale të së ardhmes - transparente, të lidhur dhe të qasshme për të gjithë.